



QENDRA E KUALIFIKIMIT PROFESIONAL AKMON K. BAKIRXHI E.E.

*Eftihias 12-14, 11251 Athinë, tel: 210 8655763, fax: 210 8655469*

[www.kekakmon.gr](http://www.kekakmon.gr) E-mail: [akmon-ath@kekakmon.gr](mailto:akmon-ath@kekakmon.gr)

INISIATIVA KOMUNITARE EQUAL  
MASA 1.2  
B. ZH. PËR BARAZINË DHE PJESMARRJEN SOCIALE  
TITULLI I I VEPRES: FORUM PËR BARAZINË DHE PJESMARRJEN SOCIALE  
NËNVEPRA9: KRIJIM MATERIALI MBËSHTETËS

**UDHËZUESI I EMIGRANTIT**

REDAKTORE:  
Nana Jaja – Bakirxhi



MINISTRIA E PUNËS DHE  
SIGURIMEVE SHOËRORE



BASHKIMI EUROPIAN KOMISIONI

EUROPIAN – F.K.E.

Vepra bashkëfinancohet nga **Ministria e Punës & Sigurimeve Shoqërore** dhe nga **Bashkimi Europian** në kuadrin e **Veprimtarive të Fondit Komunitar Europian (F.K.E.)**



"ΑΝΑΠΤΥΞΙΑΚΗ ΣΥΜΠΡΑΞΗ ΓΙΑ ΤΗΝ ΙΣΟΤΗΤΑ  
& ΤΗΝ ΚΟΙΝΩΝΙΚΗ ΣΥΝΟΧΗ"



«BASHKËVEPRIMI ZHVILLUES PËR BARAZINË  
DHE PJESMARRJEN SOCIALE»

Komisioni Shkencor :  
Nana Jaja-Bakirxhi  
Stavrula Vulgaroglu  
Maria Malapeca  
Aristidhis Revithis

Asistent redaktor: Aleksandros Mavrokefalidhis

Përkthëu: Aleks Bifsha

## PËRMBAJTJA

Hyrje.....	
Hyrja dhe qëndrimi i të huajve për ofrimim të punës në vartësi	3
Rinovimi(përtëritja) e lejes së punës.....	5
<b>KATEGORITË E LEJEVE TË QËNDRIMIT PËR TË HUAJTË</b>	
Leje qëndrimi për ofrim pune në vartësi.....	7
Leje qëndrimi për ofrim shërbimesh ose pune të pavarur.....	9
Leje qëndrimi për ofrim pune sezonale.....	10
Leje qëndrimi për arsye studimi.....	11
Leje qëndrimi për ushtrim veprimtarie biznesi të pavarur.....	13
Leje qëndrimi për bashkim familjar.....	15
Leje qëndrimi për të huajin bashkëshort-e të grekut-es ose shtetas të Bashkimit European.....	18
Hyrja dhe qëndrimi i të huajve për arsye të tjera.....	20
Avancimi i të huajve në fushën e arsimimit.....	23
Katalogë organizatash dhe institucionesh që ofrojnë mësim të përvetësimit të gjuhës greke.....	24
Detyrime dhe të drejta të të huajve (Tatimi- sigurimi).....	25
Shëndeti – Sigurimi social.....	26
Detyrimet e posiduesve të lejes së qëndrimit.....	28
Shfuqizimi(marrja pas) i lejes së qëndrimit.....	29
Detyrimet e pronarëve të huaj punonjës .....	31
Marrja e nënshtetësisë greke me regjistrimin e shtetasit(shtetasregjistrim).....	32
Tabela me organizata që mbështesin(ndihmojnë) emigrantët dhe refugjatët.....	36

## HYRJE

Udhëzuesi i emigrantit u formulua në kuadrin e **inisiativës komunitare Equal** dhe të **Bashkëveprimit Zhvillues për barazinë dhe ndërlidhjen sociale**. Adresohet tek emigrantët që kanë si qëllim të vijnë ose që ndodhen në procedurën e stabilizimit(vendosjes) në qarkun e Atikës. Ofron informacione të rëndësishme për çdo emigrant që gjendet ose ka si qëllim të hyjë në territorin grek, sepse informohet për procedurat dhe dokumentacionin që nevojitet, si dhe për institucionet shërbyese që kanë përgjegjësinë për trajtimin e çështjeve të emigrantëve.

Udhëzuesi përfshin trajtimet(qarkoret) legjislative më aktuale për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Greqi si dhe për mundësitë e hyrjes së tyre në sistemin shëndetësor dhe atë të arsimimit. Veçanrisht informon për procedurën e hyrjes dhe qëndrimin në Greqi, procedurën e rinovimit të lejes së qëndrimin dhe të punës, të drejtat dhe detyrimet e tyre. Ofron informacione për çështje që kanë lidhje me tregun e punës, sigurimin, tatimet, për mbështetjen ligjore, për arsimin, për ofrimin e shërbimeve mjekësore.

Qëllimi i kësaj përpjekjeje për depërtimin e dijës është: të ndihmojë emigrantët të futen mundësisht sa më shpejt dhe normalisht në shoqërinë greke. Në nivelin që bëhet fjalë për grup të sapofutur që nuk njeh institucionet ku mund të adresohet, procedurat që ndiqen dhe kuadrin ligjor që kushtëzon hyrjen dhe qëndrimin e të huajve, grumbullimi i informacioneve që duhen në një udhëzues, përbën ndihmesë të rëndësishme për informimin e këtij grupi. Në nivelin që bëhet fjalë për grup që njeh mangësisht ose aspak gjuhën e vendit pranues, përkthimi i udhëzuesit në gjuhë të tjera do të lehtësojë përdorimin e tij nga shumica e emigrantëve. Gjuhët në të cilat përkthehet udhëzuesi janë : anglisht, shqip, rusisht dhe turqisht.

## UDHËZUESI I EMIGRANTIT

### **Kuadri ligjor**

**Ligji 2910/01** me plotësimin dhe rishikimin e urdhëresave të tij me **L. 3013/02, 3074/02, 3146/03 dhe 3202/03** përbën kuadrin e ri legjislativ për politikën e emigracionit të Greqisë.

### **Roli i Ministrisë së Brendshme Administrimit Publik dhe Decentralizimit**

**Ministria e Brendshme planifikon dhe koordinon** politikën e emigracionit të vendit **nëpërmjet Drejtorisë së të Huajve dhe Emigracionit** të Ministrisë së Brendshme. Materializimi i kësaj politike zbatohet nga **Drejtoritë e të Huajve dhe të Emigracionit** në çdo qark të vëndit.

**Dekreton rregulla të përcaktuara** për hyrjen dhe qëndrimin e të huajve në Greqi, njuhëson arsyet për të cilat një emigrant mund të hyjë dhe të qëndrojë ligjshëm në Greqi si dhe predispozitat dhe procedurat mbi bazën e të cilave mund të bëhet kjo gjë.

**Dekreton të drejtat dhe detyrimet e emigrantëve** që jetojnë dhe punojnë në Greqi.

**Përcakton predispozitat** për marrjen e **nënshtetësisë greke** nëpërmjet regjistrimit të shtetasit(shtetasregjistrimit).

Në çdo Drejtori qarku të të Huajve dhe të Emigracionit **ngrihet Komision Treanëtarësh Emigracioni** i cili thotë mendimin e tij tek Sekretari i Përgjithshëm i qarkut për lëshimin ose rinovimin e lejes së qëndrimit të të huajit. **Mendimi i komisionit, nuk e imponon Sekretarin e Përgjithshëm të qarkut**, i cili mund të lëshojë vendim të ndryshëm nga ai i komisionit.

HYRJA DHE QËNDRIMI I TË HUAJVE  
PËR OFRIM TË PUNËS NË VARTËSI  
Neni 19 i Ligjit 2910/01

(Neni 19 paragrafi 2 & 3 i Ligjit 3013/02, Neni 32 paragrafi 10 i Ligjit 3202/03)

1. **Lejohet hyrja dhe qëndrimi i të huajit në Greqi**, për ofrim pune në vartësi në një pronar të përcaktuar dhe për lloj të përcaktuar pune, për ofrim shërbimesh ose vepre të pavarur, në rast se i lëshohet leje pune nga Prefektura.

2 a. **Në selinë e çdo qarku ngrihet Komision, i cili përbëhet prej:**

1. Sekretarit të Përgjithshëm të Qarkut ose Drejtorit të Shërbimit kompetent të Gjëndjes Civile dhe të Huajve dhe Emigrantëve si President(kryetar)
2. Shefit të Trupit të Kontrolluesve të Punës (Σ.Ε.Π.Ε.)
3. përfaqësuesit të Lidhjes së Prefekturave Greke (Ε.Ν.Α.Ε.)
4. përfaqësuesit nga Instiucioni i Punësimit të Fuqisë Punëtore (ΟΑΕΔΗ-it)
5. përfaqësuesit e punonjësve.
6. përfaqësuesit e punëdhënësve.
7. përfaqësues nga Konfederata e Përgjithshme e Shoqatave Bujqësore Greke (ΓΕΣΑΣΕ) ose nga Konfederata Ndërgreke e Lidhjes së Kooperativave Bujqësore (ΠΑΣΕΓΕΣ.)

Komisioni formulon në tremujorin e fundit të çdo viti relacion, në të cilin regjistrohen nevojat ekzistuese në fuqi punëtore në qark dhe vendet e lira të punës për çdo specialitet dhe rreth, të cilat mund të plotësohen prej të huajve. Gjatë formulimit të relacionit merren parasysh interesat e ekonomisë kombëtare, oferta e punës nga vendasit ose të huajt që qëndrojnë ligjshëm në Greqi dhe kërkesa.

**b. Në bazë të këtij relacioni përcaktohet** me vendim të Ministrisë së Punës dhe Sigurimeve Shoqërore, Min. së Brendshme, Administrimit Social dhe Decentralizimit dhe Min. së Jashtme, numri maksimal i lejeve të punës që lëshohen çdo vit për të huajtë, sipas nënshtetësisë, rrethit, llojit dhe kohëzgjatjes së punës.

**c. Ky vendim përcillet nga komisioni** në Prefekturat fqinje dhe në Autoritetet Konsullore Greke deri sa të formohen Institucionet(zyrat) e Jashtme të Gjetjes së Punës.

**3. Institucionet(zyrat) e Jashtme të Gjetjes së Punës** ftojnë me njoftimet e tyre, të cilat mund të publikohen në mjetet e informacionit rajonal të interesuarit e huaj, të parashtrorin kërkesat e tyre për punë në Greqi.

**Mbi bazën të këtyre kërkesave formulohet** gjëndja emërore e të huajve që dëshirojnë të punojnë në Greqi dhe i dërgojnë tek ΟΑΕΔΗ-i dhe institucionet e punës së Vetadministrimit Prefektural.

**4. Punëdhënësi për të pranuar personel me kontratë pune në vartësi, të shërbimeve të pavarura ose vepre të pavarur,** parashtron kërkesë në komisionin kompetent të punës të Vetadministrimit Prefektural.

5. Komisioni mund të aprovojë mbulimin e këtyre vendeve pune me të huaj që nuk banojnë në Greqi, kur vendet e punës që ekzistojnë nuk **mbulohen nga vendas ose të huaj** me banim në Greqi.

Punëdhënësi zgjedh nga listat(gjëndjet) emërore që parashikohen nga paragrafi i këtij neni, të huat që e interesojnë dhe parashtron kërkesë tek Prefekti për lëshimin e lejeve të punës tek ata.

**Kërkesa** duhet të shoqërohet nga këto shkresa:

**a. Vërtetim nga punëdhënësi** se do të pranojë në punë të huajt e përcaktuar dhe se do të ndërmarrë përsipër shpenzimet e jetesës së tyre deri sa të marrin leje qëndrimi ose, në rast se nuk do t'u lëshohet leje, deri sa të largohen nga vendi.

**b. Letër garancie bankare** me sasi të paktën të barabartë me tre rroga punëtori të pakualifikuar për mbulimin e shpenzimeve për tre muaj jetese të të huajit në Greqi dhe sasi që do të mbulojë shpenzimet e rikthimit të tij në vëndin e tij.

**Meqëse bëhet fjalë për pranimin e të huajit në punë dhe të punësuarit në ekonominë agrare**, letra e garancisë korrespondon me rrogat mujore të punëtorit të pakualifikuar.

**7 a. Leja e punës lëshohet nga Prefekti i afërm**, në rastin kur referohet në specialitet që përfshihet tek Vendimi i Përbashkët i Ministrive (K.Y.A.) në rastin b të paragrafit 2 të Nenit 11 Ligji 3202/03 me të cilin përcaktohet numri i lejeve të punës relativisht me nënshtetësinë, rrethin, llojin dhe afatin e punësimit. Lëshimi i lejes së punës bëhet mbas aprovimit nga autoriteti policor i rrethit për çështje që lidhen me rendin publik dhe sigurinë e vendit.

**b. Posiduesi i lejes së punës mund të punojë në rreth tjetër** të të njëjtit qark ose në qark tjetër me influencimin e predispozitave të paragrafit 10, të Nenit 19 të Ligjit 21910/01, ashtu siç u shtua me paragrafin 2, të Nenit 32, të Ligjit 3202/03 domethënë:

- Në rastin kur është zgjidhur kontrata fillestare e punës dhe është deklaruar e zgjidhjes së saj.
- I huaji ka formuluar kontratë të re pune më punëdhënësin në rreth tjetër.
- Ose ka vulosur (legalizuar) lejen nga institucioni kompetent i prefekturës së vendit ku do të punojë për afat të barabartë me atë që i ngelet deri në ditën e skadimit.
- dhe duke shtuar se bëhet fjalë për specialitet , i cili parashikohet tek K.Y.A. e mësipërme dhe nuk është mbuluar nga punonjës tjetër vendas ose i huaj.

**8. Leja e punës lëshohet për një periudhë deri një vit.** Mbas kalimit të dy viteve nga lëshimi i lejes fillestare, **leja e punës ka afat dyvjeçar. (L.3202/03)**

**Në rast se kontrata e punës** bëhet me afat kohor më të vogël se një vit, **leja e punës**, në bazë të lëshimit fillestar, do të lëshohet për një vit.

**9. Prefekti përcjell lejen e punës tek konsullata greke** që të jepet leje hyrjeje (vizë) dhe e publikon tek Shërbimi (institucioni) i të Huajve dhe Migracinit.

**10. Lëshimi i lejes së punës nga shërbimi kompetent i Vetadministrimit Prefektural vlen në kuadrin e afatit të saj në çdo rreth të vendit nën predispozitat e mëposhtme:**

- i. Është zgjidhur lidhja fillestare e punës dhe është deklaruar arsyeja e zgjidhjes së saj.
- ii. I huaji ka bërë kontratë të re pune me punëdhënësin në rreth tjetër.
- iii. Është vulosur leja nga institucioni i afërm i Vetadministrimit Prefektural të vendit, ku do të punojë i huaji dhe për periudhën kohore të barabartë me atë që i ngelet.

**Viza (Vula e Hyrjes)**

**Neni 20 L.2910/01**

**Për dhënien e vulës së hyrjes (Vizës)** për punë në vartësi të shërbimeve të pavarura ose vepra kërkohet të grumbullohen tek organi konsullor grek i vendit të banimit të tij dokumentat e mëposhtme:

- a. Pasaportë e vlefshme dhe çertifikatë e amzës penale** e organeve të huaja.
- b. Leje e përcaktuar pune** për të huajin dhe lloji i përcaktuar i punës që përciell prefekti.

Nga të mësipërmet si dhe nga urdhëresat e Neneve 21 – 23 të Ligjit 2910/01 përcaktohet qartë se **leja e punës** së të huajit që lëshohet nga institucionet kompetente të vetadministrimeve prefekturale **është një dokument justifikues i domosdoshëm për lëshimin e lejes së qëndrimit.**

**Të huajit i lejohej të lidhë kontratë pune** me punëdhënësin tjetër brenda afatit të vlefshmërisë së lejes së punës dhe qëndrimit të tij, por duhet **të informojë institucionin kompetent të Punës të prefekturës** në mënyrë që të lëshohet leja relative e punës, duke paraqitur paralelisht edhe kontratën e punës që ka bërë më pronarin e ri.

**I huaji, që dëshiron përtëritjen e lejes së punës së tij**, ka si detyrë që brenda afatit, para skadimit të saj, të deponojë lutje në Zyrën e Punës të Prefekturës me dokumentat përkatëse.

**Në vazhdim jepet tabela me dokumentat e nevojme që duhet të paraqiten.**

### **PËRTËRITJA E LEJES SË PUNËS**

L. 2910/01 Nenet 12 dhe 23

**Dy muaj para dhe deri në ditën që mbaron leja e punës**

**Paraqiten këto dokumenta në zyrat e punës së**

**PREFEKTURËS**

1. **Kërkesë për përtëritjen e lejes së punës.**
2. **Leje pune** ( origjinali dhe fotokopja e legalizuar)
3. **Leje qëndrimi** ( origjinali dhe fotokopja e legalizuar)
4. **Fotokopje e deklaratës së tatimeve** e legalizuar nga zyra e tatim- taksave(eforia)
5. **Pashaporta** (origjinali dhe fotokopja e legalizuar)
6. **Letër pastërtie(ekatharistiko) ose deklaratë tatimesh.**
7. **Informacion tatimor A7**
8. **Kontratë pune** ( me firmën origjinale të punëdhënësit të vulosur nga policia)
9. **Deklaratë përgjegjësie(ipeftini dhllosi)** e pronarit se kontrata e punës është në fuqi(e vlefshme) ( me firmën origjinale të punëdhënësit të vulosur nga policia).

### **PËR PUNË NË VARTËSI:**

**Ensima(ditë sigurimi)** (Fragment nga llogaria personale e siguracionit ose vërtetim punëdhënësi), nga dita e lëshimit të lejes së punës deri në datën e dorëyimit të dokumentacionit për përtëritjen e lejes së punës pa boshllëk-shkëputje.

**Në rast se kanë punuar më pak kohë** gjatë afatit të lejes së qëndrimit të tyre, do të duhet **të faktojnë absolutisht të dokumentuar** arsyen për të cilën nuk punuan në sfatin e përcaktuar kohor. **Si shembull: raste** të mungesës së justifikuar nga puna dhe dokumentat justifikuese që duhet të paraqin janë:

a. **Ishte i/e papunë.** Duhet të paraqesin vërtetim të O.A.E.DH-it nga i cili do të vërtetohet afati kohor për të cilin merrte ndihmë(subvencionim) rregullisht për papunësinë ose regjistrimin e tij në amzat e e të papunëve të O.A.E.DH-it, duke paraqitur paralelisht kartën relative të papunësisë.....



të vulosur çdo muaj nga shërbimi kompetent i O.A.E.DH-it

**b. Ishte i/e sëmurë** : Duhet të paraqesë ekspertizë prej spitali shtetëror për afatin kohor të sëmundjes së tij/saj.

**c. Udhëtoi jashtë Greqisë**. Duhet të paraqitet fotokopje e pashaportës për afatin kohor të mungesës së tij(vulë dalja dhe hyrje).

### **11. PËR PUNË TË PAVARUR:**

- **Pastruese, kopshtarë etj. 150 ensima**
- **Punëtorë ndërtimi, Ndihmëse e të sëmurit, Infermiere 130 ensima(ditë të pastra pa shtimet e IKA-ve)**

### **OGA: PUNË BUJQËSORE**

**a. Librezë shëndeti në fuqi** (fotokopje e legalizuar) ose

**b. Deklaratë e punëdhënësit e legalizuar nga korespondenti i OGA-së** në të cilën do të paraqiten të paktën 150 ditë pune, që duhet të jenë bërë domosdoshmërisht gjatë afatit kohor të vlefshmërisë së lejes së punës.

### **T.E.V.E PROFESIONISTË TË LIRË**

**a. Librezë shëndeti në fuqi** (fotokopje e legalizuar) ose

**b. Vërtetim që nuk ka detyrime** në institucionin sigurues konkret.

### **ZYRA TË PREFEKTURËS NË ATHINË**

Liosion 93 tel. 210 8842006
H. Trikupi 152 tel. 210 6471027
Ahileos 73 tel 210 3460410 Sheshi Karaiskaqi
Ethnikis Andistaseos 158 Ajios Dhimitrios Tel. 210 9764353 210 9764317
Katehaki 61A tel. 210 6717638
Theseos 283 Kalithea tel. 210 9429526

**KUJDES:** Fotokopjet e dokumentave të paraqitura mund të legalizohen në zyrat e punës të Prefekturës me tregimin e origjinaleve.

## KATEGORITË E LEJEVE TË QËNDRIMIT TË TË HUAJVE

### 1. LEJE QËNDRIMI PËR OFRIM PUNE NË VARTËSI

Punë në vartësi është puna që ofrohet në një punëdhënës të përcaktuar për një kohë të përcaktuar ose jo dhe me rogë të përcaktuar.

<p><b>Lëshimi i lejes së qëndrimit.</b> <b>Neni 21 L. 2910/01</b></p>	<p>I huaji që ofron punë në vartësi, që të paiset me leje qëndrimi, duhet të paraqesë kërkesë në <b>Bashki ose Komunën përkatëse të vendbanimit të tij</b> dy muaj para mbarimit të vizës.</p> <p>Kërkesa duhet të shoqërohet me:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Fotokopje të pashaportës së tij</b> e cila duhet të ketë vizë në fuqi(d.mth.të mos jetë e skaduar) <b>Viza të jetë vizë pune për ofrim të punës në vartësi.</b></li> <li><b>2. Tre fotografi</b> me ngyra</li> <li><b>3. Fotokopje e legalizuar e lejes së punës</b></li> <li><b>4. Fotokopje e legalizuar e kontratës së punës në vartësi.</b></li> <li><b>5. Të dhëna që vërtetojnë</b> se është i siguar për të mbuluar shpenzimet e kurimit(spitalor), të përkujdesit mjeksor dhe farmaceutik dhe për mbulimin e aksidentit në punë ose që ka bërë kërkesën relative për sigurimin e tij.</li> <li><b>6. Çertifikatë shëndeti(letër spitali)</b> e cila do të lëshohet prej institucioneve mjeksore shtetërore ose qëndrave mjeksore, ose prej ambulancave kuruese të IKA-ve, e cila vërteton se i huaji nuk vuan nga sëmundje e cila, në përputhje me të dhënat ndërkombëtare dhe Organizatën Ndërkombëtare të Shëndetit(O.ND.SH.), mund të shkaktojë rrezik për shëndetin publik. Shpenzimet bëhen nga i interesuari i huaj.</li> <li><b>7. Kuotë(paravolo)147 Euro</b> nga zyra e tatimeve</li> <li><b>8. Deklaratë e thjeshtë e të huajit</b> në të cilën paraqitet <b>adresa e banimit të tij.</b> Në rast se deklarata nuk është e vërtetë, zbatohet gjobitja në bazë të Nen. 54 paragrafi 4 i atij Ligji (nga 1500 – 2950 euro).</li> </ol> <p>Leja e qëndrimit lëshohet nga Sekretari i Përgjithshëm i Qarkut ose nga nëpunësi i autorizuar prej tij.</p>
---	--

**PËRTËRITJA E LEJES SË QËNDRIMIT  
PËR OFRIM TË PUNËS NË VARTËSI**

**Neni 22 i Ligjit 2910/01 (Neni 8, paragrafi 3 i Ligjit 3146/03)**

<p><b>Pas marrjes së lejes së punës, paraqet në bashki ose në prefekturën e vendbanimit të tij, dy muaj para mbarimit të saj dhe deri në ditën që mbaron leja e qëndrimit të tij dokumentat e mëposhtme:</b></p>	<ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Kërkesë për përtëritjen e lejes së qëndrimit.</b></li> <li><b>2. Fotokopje të pashaportës së tij</b> (pashaporta duhet të jetë e vlefshme-në fuqi)</li> <li><b>3. Fotokopje të legalizuar të lejes së qëndrimit.</b></li> <li><b>4. Tre fotografi me ngjyra</b></li> <li><b>5. Fotokopje e legalizuar e kontratës së punës në vartësi.</b></li> <li><b>6. Fotokopje e legalizuar e lejes së punës.</b></li> <li><b>7. Fotokopje të shënimit të pastërtisë tatimore(ekatharistiko) të Zyrës Tatimore(Eforisë) për vitin e fundit ekonomik. Në rast se të ardhurat e tij nuk i nënshtrohen tatimit, pasi janë të pakta, do të nevojitet paraqitja nga ana e tij deklarate përgjegjësie të L. 1599/86 që paraqet sasinë e të ardhurave.(Të vulosur nga Eforia).</b></li> <li><b>8. Të dhëna që vërtetojnë se është i siguar për të mbuluar shpenzimet e kurimit(spitalor), të përkujdesit mjeksor dhe farmaceutik dhe për mbulimin e aksidentit në punë dhe se ka shlyer detyrimet e tij siguruese ose fotokopje të librezës së shëndetit të vulosur për vitin në vazhdim dhe kartelën e ditëve të sigurimit(ensimave)</b></li> <li><b>9. Kuotë(paravolo)147 Euro nga zyra e tatimeve, ashtu siç kushtëzon Neni 71 i L.2910/01</b></li> <li><b>10. Deklaratë e thjeshtë e të huajit në të cilën paraqitet adresa e banimit të tij.</b></li> </ol>
--	---

**KUJDES: Pas kalimit të dy viteve nga data e lëshimit të lejes fillestare, përtëritja e lejes së qëndrimit bëhet me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të qarkut të afërm çdo dyvjeçar dhe ka afat dyvjeçar.**

**Pas një totali dhjetëvjeçar qëndrimi në Greqi dhe nën ato kushte qëndrimi, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të qarkut të afërm mund të lëshohet leje qëndrimi me afat të pacaktuar.(Neni 32 paragrafi 3, të L. 3202/03)**

**Pas deponimit të kërkesës nga i huaji për përtëritjen e lejes së punës ose të qëndrimit, para mbarimit të lejes së mëparshme të qëndrimit, konsiderohet i ligjshëm në vënd deri sa administrata të nxjerrë vendimin e saj në lidhje me kërkesën.(Nen. 32 paragrafi 12 i Ligj. 3202/03)**

**Në rast se i huaji është i martuar dhe me fëmijë, duhet të deponojë akoma:**

- 1. Dy fotokopje të legalizuara të pashaportave për të gjithë pjesëtarët e familjes mbi 14 vjeç.**
- 2. Dy fotokopje të legalizuara të lejeve të qëndrimit për të gjithë pjesëtarët e familjes.**
- 3. Dy fotografi për çdo pjestar të familjes mbi 14 vjeç.**
- 4.Çertifikatë familjare e freskët, e dalë mbas datës së daljes së lejes së qëndrimit të tij nga e cila rezulton lidhja familjare. Çertifikata duhet e legalizuar dhe e përkthyer në greqisht si dhe fotokopja e saj dhe e përkthimit të jenë të legalizuara.**

5. **Kuotë(paravolo)** nga arkat shtetërore 146,74 euro për çdo person mbi 14 vjeç.
6. **Deklaratë e thjeshtë e të huajit** në të cilën përmendet adresa e banesës së tij dhe se pjestarët e familjes bashkëjetonin dhe bashkëjetojnë me të, e fotokopjuar dy herë.
7. **Librezë shëndeti** e vulosur për vitin në vazhdim, dy fotokopje.
8. **Librezë vaksinash**
9. **Çertifikatë shëndetësore të fëmijëve.**

**2. LEJE QËNDRIMI PËR OFRIM  
TË SHËRBIMEVE TË PAVARURA OSE VEPRE  
Neni 23 i Ligjit 2910/01**

**Shërbime të pavarura ose vepër** mund të ofrojë një pastruese, ndihmëse shtëpiake, një kopshtar etj, që nuk kanë biznes të tyre, gjithashtu nuk punojnë nën urdhërat e një punëdhënësi, por nën urdhërat e më shumë se një punëdhënësi, d.m.th, nuk ekziston lidhje vartësie me një punëdhënësi të përcaktuar.

<p><b>Ofrim të lejes së punës për ofrim të shërbimeve të pavarura ose vepre.</b> Nenet 19,20,21,22 të Ligjit 2910/01</p> <p><b>Përtëritja e lejes së qëndrimit për ofrimin e shërbimeve të pavarura ose vepër.</b> Neni 23 L. 2910/01</p>	<p><b>Për paisjen e të huajve që ofrojnë shërbime të pavarura ose vepër me leje qëndrimi</b> ndiqet e njëjta procedurë që kërkohet për lëshimin e lejes së qëndrimit në të huaj që ofrojnë punë në vartësi (zbatohen urdhëresat e neneve 19,20,21,22).</p> <p>E vetmi ndryshim është se, në vënd të kontratës së punës në vartësi, duhet paraqesin kontratë të ofrimit të shërbimeve të pavarura ose vepër së pavarur.</p> <p><b>Për përtëritjen e lejes së punës për ofrimin e shërbimeve të pavarura ose vepër</b> ndiqet e njëjta procedurë me atë të përtëritjes së lejes së punës në vartësi, por në vënd të kontratës së ofrimit të shërbimeve ose vepër mund të paraqiten :</p> <p><b>a. Deklaratë e punëdhënësit</b> se do të punësojë të huajin në punë të përcaktuar me afat të përcaktuar ose</p> <p><b>b. Librezë sigurimi(ensima)</b> nga e cila do të rezultojë se ka kryer numër ditësh pune të paktën të barabartë me gjysmën e ditëve të punëshme që korrespondojnë në afatin kohor nga lëshimi i lejes së punës deri në deponimin e kërkesës për përtëritjen e saj.</p> <p><b>c. Fotokopje e bllokut të faturave i cili do të vuloset nga IKA.(duhet të ketë me vete edhe origjinalin)</b></p>
---	--

**3. LEJE QËNDRIMI PËR OFRIM TË PUNËS SEZONALE  
Neni 24 L. 2910/10**

1. **Punë sezonale e të huajit** është punësimi i tij në Greqi për afat kohor totalishtë deri 6 muaj për vit kalendarik në sektorë veprimtarie që lidhet me sezonet,

me kontratë pune me kohë të përcaktuar dhe nën predispozitën se i huaji ka banesë në Greqi.

**2. Punëdhënësi, që dëshiron të punësojë të huajin ose të huajtë për punë sezonale në Greqi,** paraqet lutjen në shërbimin kompetent të punës të Prefekturës të paktën tre muaj para fillimit të punimeve.

**3. Veçanërisht për Shqipërinë dhe Bullgarinë** ekziston marrëveshje dypalëshe për punë sezonale.

**4. Kërkesa- lutja përcillet tek O.A.E.DH –i për miratim.** Në rast se O.A.E.DH-i miraton kërkesën në fjalë, (në përputhje me kufizimet e paragrafit 5, Nen. 19) punëdhënësi zgjedh nga listat emërore që parashikohen nga paragrafi 3 i Nen. 19 dhe bën veprimet e mëposhtme:

<p><b>Veprime para mbërritjes së tyre në Greqi</b></p>	<p><b>Shtron kërkesë tek prefekti</b> për lëshimin e lejes së punës për të huaj, të përcaktuar, të zgjedhur prej tij, duke deponuar edhe miratimin relativ të O.A.E.DH-it dhe këto dokumenta:</p> <p><b>a. Deklaratë përgjegjësie e pronarit</b> se do të pranojë në punë të huajt e përcaktuar dhe se merr përsipër shpenzimet e jetesës së tyre deri sa të marrin leje qëndrimi, ose, në rastin kur nuk lëshohet leje qëndrimi për ta, deri sa të largohen nga Greqia.</p> <p><b>b. Letër garancie nga banka</b> siç përkufizohet tek paragrafi 6b i Nenit 19.</p> <p><b>c. Kontrata personale pune</b> tek të cilat referohet: lloji, kushtet e punës, afati kohor i punësimit dhe pagesa e kontraktuar, e cila nuk mund të jetë më e ulët se ajo e punëtorit të pakualifikuar. Kontratat personale të punës duhet të jenë të firmosura në të njëjtën ditë nga pronari dhe të vulosura nga ΣΕΠΕ.</p> <p><b>d. Shërbimet e prefekturës përcjellin tek Organet Kosullore ose tek Zyrat e Jashtme të Gjetjes së Punës</b> kërkesat e pronarëve të interesuar dhe kontratat personale të punës</p> <p><b>e. Organet Kosullore ftojnë të huajt</b> të cilët duhet të paraqiten personalisht, duke paraqitur dokumentat e Nenit 6 të Shtojcave të kontratave që janë:</p> <p><b>a. Të kenë moshën nga 21 deri 60 vjeç</b></p> <p><b>b. Të jenë posidonjës të amzës penale të bardhë.</b></p> <p><b>c. Të kenë certifikatë shëndetësore të legalizuar.</b></p>
--	--

	<p><b>d. të jenë posidonjës të titullit analog të studimeve</b> kur bëhet fjalë për punë të specializuar.</p> <p><b>e. Të mos kenë detyrime ndaj shërbimit ushtarak.</b> Pasi të jenë kontrolluar dokumentat e mësipërme nga Organet Konsullore, <b>ftohen të huajt, të nënshkruajnë dhe të marrin kontratat personale,</b> të cilat legalizohen nga Organet Konsullore dhe në vazhdim marrin Vizë të ligjshme për hyrjen e tyre në Greqi.</p> <p>Gjatë mbrritjes së tyre në Greqi, bullgarët ose shiptarët e gjedhur, që vijnë për punë detyrohen:</p> <p><b>1. Të kenë me vete kontratën personale</b> të nënshkruar dhe vulosur nga Organi Konsullor.</p> <p><b>2. Dokumentat e parashikuara</b> nga Neni 6 i shtojcave ( përmenden në pikën e veprime para mbrritjes), të cilat duhet të jenë të përkthyer zyrtarisht dhe brenda 10 ditëve të deponohen në institucionet kompetente të vendit të punës, në bazë të Nenit 7 të shtojcave të marrëveshjeve.</p> <p><b>3. Organet kompetente lëshojnë leje pune dhe qëndrimi mbas lutjes së të huajve.</b></p>
--	---

**LEJE QËNDRIMI PËR ARSYE STUDIMESH**  
**Hyrja dhe qëndrimi i të huajve për arsye studimesh**  
**Neni 10 L. 2910/01**  
**(Neni 19 i L.3013/02 paragrafi 1b )**

**1. Hyrja e të huajit për studime** në Greqi, në Universitete, në Institucione Arsimore Teknologjike(T.E.I.) në Fakultete të Larta Kishtarë dhe njësi shkollore, në Fakultetin e Lartë të Arsimtarëve Teknologë dhe Arsimin Teknik, në Fakultetin e Profesioneve Turistike të Org. Turist. Grek(E.O.T.), në Institutet Teknike dhe Profesionale(T.E.E.), në shkollën e Gjuhës Greke të Universiteteve të Athinës ose Selanikut, ose në Qendrën e Gjuhës Greke të Selanikut, lejohet në rast se ka marrë vizë hyrjeje për këtë arsye.

**2. Për paisjen e të huajit me vizë për studime** duhet:

- a. Të pranohet në njërin nga institucionet arsimore** që përmenden në paragrafin 1.
- b. Të sigurojë shpenzimet e studimeve dhe të jetesës së tij** në Greqi.

**3. I huaji, që dëshiron të vijë në Greqi për studime,** duhet të paraqesë në Konsullatën Greke të vendbanimit të tij:

- a. Pashaportë ose dokument tjetër udhëtimi.**
- b. Vërtetim prej institucionit arsimor grek (origjinal),** se e pranon të regjistrohet në të.

c. Deklaratë që tregon se ka siguruar mjetet ekonomike të nevojshme për shpenzimet e studimeve të tij në Greqi.

d. Çertifikatë të amzës penale(gjëndjes gjyqsore) nga organet e vendit të tij.

<p><b>Lëshimi i lejes së punës për studime.</b> Neni 11 i L. 2910/01</p>	<p><b>Për paisjen e të huajit me leje qëndrimi</b> për studime në greqi duhet:</p> <p><b>A. Të deponojë kërkesë në bashki ose Komunën</b> e vendbanimit të tij dy muaj para mbarimit të vizës. Kërkesa duhet të paraqesë qëllimin e paisjes së tij me leje qëndrimi.</p> <p><b>Kërkesa duhet të shoqërohet nga:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Fotokopja e pashaportës së tij</b> me vulë hyrjeje(vizë), e cila duhet të jetë për studime.</li> <li><b>2. Tre fotografi me ngjyra.</b></li> <li><b>3. Vërtetim(origjinal) nga institucioni arsimor kompetent</b> se është regjistruar në të.</li> <li><b>4. Të dhëna që vërtetojnë se:</b> mund të mulojë shpenzimet e studimeve brënda afatit të fuqisë së lejes së qëndrimit të tij. Të dhëna të tilla janë p.sh., llogari depozitimesh, llogari bankare, vërtetim nga prindi me legalizimin e origjinalitetit të firmës së tij nga Konsulli Grek i afërm, se merr përsipër mbulimin e shpenzimeve të fëmijës së tij, faturë pagese(me qënë se lejohet për ata që studjojnë, puna e përkohëshme).</li> <li><b>5. Vërtetim nga institucioni i sigurimit se:</b> është i siguruar për të mbuluar shpenzimet e kurimit(spitalor), të përkujdesit mjeksor dhe farmaceutik. Institucioni i sigurimit mund të jetë privat ose shtetëror.</li> <li><b>6. Çertifikatë shëndeti(letër spitali),</b> e cila do të lëshohet prej institucioneve mjeksore shtetërore dhe do të vërtetojë se nuk vuan nga sëmundje, e cila mund të përbëjë rrezik për shëndetin publik.</li> <li><b>7. Kuotë(paravolo)147 Euro</b> nga zyra e tatimeve, ashtu siç kushtëzohet nga Neni 71 i këtij ligji.</li> <li><b>8. Deklaratë e thjeshtë e të huajit</b> në të cilën paraqitet <b>adresa e banimit të tij.</b> Në rast se deklarata nuk është e vërtetë, zbatohet gjobitja në bazë të Nen. 54, paragrafi 4 i atij Ligji.</li> </ol> <p><b>Të gjitha dokumentat përveç pashaportës, duhet të jenë të legalizuara (legalizimi bëhet edhe në zyrat e Bashkisë ku dorëzohen dokumentat justifikuese).</b></p>
--	--

<p><b>Afati dhe përtëritja e lejes së qëndrimit</b> <b>Neni 12 i Ligj. 2910/01</b></p> <p><b>Përtëritja e lejes së qëndrimit</b> <b>Neni 13 i Ligj. 2910/01</b> <b>(Neni 8 paragrafi 3 i Ligjit 3146/03)</b></p>	<p><b>Leja e qëndrimit vlen për një vit</b> dhe mund të përtëritet çdo herë për një vit. Koha totale e qëndrimit nuk mund të tejkalojë afatin total të studimeve e shtuar me gjysmën e këtij afati. Këtij afati i shtohet edhe një vit për mësimin e gjuhës greke.</p> <p><b>Për përtëritjen e lejes së qëndrimit, i huaji detyrohet dy muaj para mbarimit të saj,</b> të deponojë në bashki ose në komunën e vendbanimit të tij, kërkesë të shoqëruar me të gjitha dokumentat justifikuese (<b>përveç certifikatës së shëndetit</b>), që i referohen Nenit 11 (lëshimi i lejes së qëndrimit), duke shtuar <b>vërtetimin (original) të institucionit arsimor përkatës</b> nga i cili rezulton regjistrimi dhe pjesmarrja e tij në provime.</p>
--	--

**5. LEJE QËNDRIMI PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË BIZNESIT TË PAVARUR**  
**Neni 25 i Ligjit 2910/10**

<p><b>Leje ushtrimi të veprimtarisë ekonomike të pavarur</b></p>	<p><b>1. Predispozitat për hyrjen e të huajit në Greqi për veprimtari të përcaktuar janë:</b></p> <p><b>a. Të disponojë të ardhura ekonomike të mjaftueshme</b> për ushtrimin e veprimtarisë konkrete.</p> <p><b>b. Kjo veprimtari, të influencojë në zhvillimin e Ekonomisë Kombëtare të vendit tonë.</b></p> <p><b>2. Kërkesa për lëshimin e lejes, deponohet në organet e konsullatës greke të vendbanimit të të huajit dhe shoqërohet nga këto dokumenta:</b></p> <p><b>a. Studim tekniko-ekonomik</b> në të cilin përfshihen të paktën lloji dhe sasia e investimit, si dhe burimet e kreditimit.</p> <p><b>b. Certifikatë të informacionit tatimor</b> të vëndit nga ka ardhur.</p> <p><b>c. Të dhëna që tregojnë kualifikimin shkencor, teknik ose profesional,</b> në lidhje me veprimtarinë që do të ushtrojë (diploma, etj )</p> <p><b>d. Certifikatë të amzës penale të organeve të huaja.</b></p> <p><b><u>Të gjitha dokumentat e mësipërme, duhet të jenë të përkthyer zyrtarisht në gjuhën greke dhe të legalizuara.</u></b></p>
--	--





Leja e qëndrimit lëshohet për dy vjetë dhe mund të përtërihet për afat të barabartë .

Pas dhjetë vjetësh qëndrimi total në Greqi dhe nën të njëjtat predispozita, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të qarkut përkatës, mund të lëshohet leje qëndrimi me afat të pakufizuar. ( Neni 32 par. 4 i L. 3202/03 )

## 6. LEJE QËNDRIMI PËR BASHKIM FAMILJAR

<p>Viza e hyrjes Neni 28 l. 2910/01</p>	<p><b>1. I huaji që jeton ligjshëm në Greqi të paktën për dy vjet, ka mundësinë, të kërkojë hyrjen dhe stabilizimin në vendin tonë të pjesëtarëve të familjes në rastin kur :</b></p> <p><b>a. Pjesëtarët e familjes së tij</b> duhet të banojnë me të.</p> <p><b>b. Disponon rrogë personale të qëndrueshme</b> për nevojat e familjes së tij, që <b>nuk mund të jetë më e vogël se dita e punës së punëtorit të pakualifikuar</b> si dhe <b>banesë të përshtatshme dhe sigurim shëndetësor</b> për të mbuluar edhe antarët e familjes së tij.</p> <p><b>c. Si pjesëtarë të familjes së të huajit konsiderohen :</b></p> <p><b>a. bashkëshorti/ja</b></p> <p><b>b. fëmijët e tij nën moshën 18 vjeç</b></p> <p><b>c. fëmijët beqarë të tij ose të gruas nën moshën 18 vjeç</b> në rastin kur ai/ajo ka përfituar për kujdesin familjar.</p> <p><b>H huaji që dëshiron bashkimin familjar duhet të deponojë kërkesë për lëshim të vizës në bashki ose në komunën e vendbanimit të tij duke paraqitur këto dokumenta :</b></p> <p><b>1. Fotokopje të legalizuar të lejes së tij të qëndrimit</b></p> <p><b>2. Shënim pastrues (ekatharistiko) nga zyra tatimore</b> për vitin e fundit ekonomik ose deklaratë tatimore për vitin e fundit ekonomik para deponimit të kërkesës.</p> <p><b>3. Çertifikatë familjare të freskët.</b></p> <p><b>4. Deklaratë të thjeshtë se pjesëtarët e familjes së tij do të banojnë me të.</b></p> <p><b>5. Deklaratë e thjeshtë e të huajit në të cilën paraqitet adresa e banimit të tij.</b> Në rast se deklarata nuk është e vërtetë, zbatohet gjobitja në bazë të Nen. 54, paragrafi 4 i atij Ligji.</p>
---	---

**Sekretari i Përgjithshëm i qarkut**, pas marrjes së mendimit të organit policor të afërm, vendos për lëshimin ose jo të vizës dhe informon relativisht organin konsullor grek në vendin e të huajit, i cili lëshon vizën tek pjestarët e familjes së të huajit.

<p><b>Lëshimi i lejes së qëndrimit.</b> <b>Neni 29 L. 2910</b></p>	<p>Për paisjen me leje qëndrimi <b>për bashkim familjar</b>, pjestari i familjes që ka ardhur me vizë në Greqi, duhet të <b>bëjë kërkesë në bashki ose në komunën e vendbanimit të tij.</b> <b>Tek fëmijët që kanë mbushur moshën 14 vjeç</b> lëshohet leje qëndrimi personale, kërkesa bëhet nga personi që ushtron përkujdesin familjar. <b>Për fëmijët nën moshën 14 vjeç si dhe për fëmijë që lindin në Greqi</b>, qëndrimi i tyre mbulohet nga leja e qëndrimit të prindit që ushton përkujdesin familjar. <b>Kërkesa</b> duhet të shoqërohet me : <b>1. fotokopje të pashaportës në fuqi</b> me vizën e hyrjes në fuqi . <b>2. Tre fotografi me ngjyra.</b> <b>3. Kuotë(paravolo) 147 euro</b> nga zyra tatimore. <b>4.Çertifikatë shëndeti(letër spitali)</b> prej institucioneve mjeksore shtetërore.</p> <p>Sekretari i Përgjithshëm i qarkut ose në rast se është autorizuar organ tjetër, lëshon vendimin e lëshimit të lejes së qëndrimit.</p>
<p><b>Afati dhe përtëritja e lejes së qëndrimit</b> <b>Neni 30 L. 2910</b> <b>(Neni 8 par. 3 i L. 3146/03)</b> <b>(Neni 32 par.5, i L. 3212 12/03)</b></p>	<p><b>Leja e qëndrimit lëshohet për afat kohor të barabartë me atë të lejes së posiduesit kryesor</b> dhe ndjek fatin e lejes së qëndrimit të tij, përjashtohet rasti i lëshimit të lejes së qëndrimit me afat të pacaktuar, për të cilën 10-vjeçari i nevojshëm duhet të plotësohet veças për çdo pjestar të familjes së tij, në përputhje edhe me predispozitat e veçanta të paragrafit 2, të Nen. 28, të L. 2910/01</p> <p>I Huaji që dëshiron të përtërijë lejen e qëndrimit për arsye të bashkimit familjar detyrohet të paktën dy muaj para mbarimit të saj, të deponojë kërkesën relative tek bashkia ose komuna e vendbanimit të tij njëkohësisht me kërkesën për përtëritjen e lejes së qëndrimit të posiduesit kryesor, duke paraqitur të njëjtat dokumenta që përmenden tek Nen.29 (përveç çertifikatës së shëndetit) dhe si shtesë <b>një çertifikatë</b></p>

<p><b>Ushtrim i aktivitetit Profesional</b> Neni 31 L. 2910</p>	<p><b>familjare të freskët nga e cila rezulton lidhja me kryefamiljarin.</b></p> <p>Personat që u pranuan për arsye të bashkimit familjar, lejohen të punojnë në marrëdhënie pune në vartësi, ose të ofrojnë shërbime të pavarura ose vepër të pavarur, ose të ushtrojnë aktivitet ekonomik të pavarur pas paisjes me leje pune. <b>Për paisjen me leje pune, deponojnë kërkesë në zyrën e punës të prefekturës, duke paraqitur këto dokumenta :</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Lejen e qëndrimit për arsye të bashkimit familjar.</b></li> <li><b>2. Tre fotografi me ngjyra.</b></li> <li><b>3. Çertifikatë të amzës penale të tipit A.</b></li> <li><b>4.Çertifikatë shëndeti(letër spitali)</b> prej institucioneve mjeksore shtetërore.</li> <li><b>5.Deklaratë në të cilën përmendet adresa e vendbanimit të tyre.</b></li> <li>6. Fotokopje e legalizuar e <b>librezës shendetësore</b>, ose fotokopje e legalizuar e <b>librezës së sigurimit (së ensimave)</b>, ose deklaratë nga punëdhënësi të vulosur nga IKA, ose fotokopje të legalizuar të <b>dokumentit regjistruar</b>(për ata që sigurohen për herë të parë tek IKA).</li> </ol> <p><b><u>6. a. Për punë në vartësi</u></b> Kontratë pune në vartësi</p> <p><b><u>b. Për punë të pavarur</u></b> Kontratë pune jo në vartësi</p> <p><b><u>c. Për ushtrim të aktivitetit ekonomik të pavarur</u></b> Studim tekniko-ekonomik për llojin dhe sasinë e investimit si dhe burimet e kreditimit dhe të dhëna që tregojnë kualifikimin teknik ose profesional të tij.</p>
<p><b>Leje e pavarur Qëndrimi</b> Neni 32 L.</p>	<p>Persona që kanë marrë leje qëndrimi për arsye të bashkimit familjar, mund të marrin leje qëndrimi të pavarur në Greqi kur:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>a. Arrijnë moshën.</b></li> <li><b>b. Humbet jetën i huaji</b> që i solli në Greqi.</li> <li><b>c. I huaji që i solli, ushtron dhunë</b> në dëm të tyre</li> <li><b>d. Kanë marrë divorc.</b></li> </ol> <p>Deponojnë kërkesë në bashki ose në komunën e vendbanimit të tyre.</p> <p><b>Kërkesa duhet të shoqërohet nga:</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><b>1. Çertifikata e lindjes</b> në rastin e arritjes së moshës.</li> <li><b>2. Çertifikata e vdekjes së të huajit</b> që e solli në Greqi për rastin e vdekjes së tij.</li> <li><b>3. Fotokopja e legalizuar e denoncimit</b> që ka</li> </ol>

	<p>deponuar personalisht në organin kompetent( Rajonin e Policisë, Sekretarinë e Barazisë etj.), në rastin kur i huaji ushtron dhunë mbi pjesëtarin e familjes së tij.</p> <p><b>4. Vendim divorcimi</b>, në rastin e ndarjes.</p> <p><b>5. Fotokopje të pashaportës së tij.</b></p> <p><b>6. Lejen e mëparshme të qëndrimit.</b></p> <p><b>7. Tre fotografi me ngjyra.</b></p> <p><b>8. Kuotë(paravolo) 147 euro</b> nga zyra tatimore.</p> <p><b>9.Çertifikatë shëndeti(letër spitali)</b> prej institucioneve mjeksore shtetërore.</p> <p>Afati i lejes së qëndrimit për rastin (a), <b>nuk e tejkalon vitin dhe mund të përtërihet për një plus një vit, deri në plotësimin e moshës 21 vjeç</b> (plotësim i L. 3074/4-12-02). Përtëritja e mëtejshme bëhet në përputhje me parashikimet e ligjit prezent. Në rastin kur leja e mësipërme rinovohet për studime, mund të rinovohet pas mbarimit të studimeve në përputhje me parashikimet e ligjit prezent.</p> <p><b>Në rast se leja nuk përtërihet pas kalimit të 6 muajve, i huaji, duhet të braktisë territorin grek.</b></p>
--	---

**7. LEJE QËNDRIMI E TË HUAJIT/ES BASHKËSHORT/E TË GREKUT/ES  
OSE PËR SHTETAS TË BASHKIMIT EVROPIAN**  
Neni 33 L. 2910/01 siç u përmirësua me Nenin 19 të L. 3013/02, dhe  
Nenin 11 par. 4 dhe 5 të L. 3074/4-12-02

**1. Tek i/e huaji/ja, bashkëshort/e i/e vendasit/ses, ose shtetas i vendit të Bashkimit Evropian lëshohet leje qëndrimi me afat minimal 5 vjetësh, e cila funksionon edhe si leje pune. E njëjta leje, mbulon edhe fëmijët e të huajit nën moshën 18 vjeç në rast se ai ushtron përkujdesin familjar.**

**Predispozitë e domosdoshme për të drejtën personale të përtëritjes së lejes së qëndrimit është: të paraqesë dy muaj para skadimit të lejes fakte që tregojnë se martesë është në fuqi,( deklaratë përgjegjësie e L.1599/1986 nga bashkëshorti/ja Grek/e ose nga shtetasi i vendit të Bashkimit Evropian dhe çertifikatë familjare të freskët)**

**2. Kjo leje nuk lëshohet ose në rast se është lëshuar anulohet, kur verifikohet se qëllimi kryesor i kryerjes së marrtesës, ishte paisja e të huajit me leje qëndrimi ose me nënshtetësi Greke.**

**3 Të njëjtit trajtim, të paragrafeve të mësipërme, i nënshtrohen edhe të huajt që janë bashkëshortë të riatdhesuarve, ose të personave me origjinë greke si dhe të huajt që janë në gjëndje vejësie dhe fëmijët adoleshentë të tyre në rastin kur bashkëshorti i vdekur ishte shtetas grek, ose shtetas i vëndeve të Bashkimit Evropian, ose i riatdhesuar, ose me origjinë greke.**

**4. Si pjestar të familjes së Grekut/es, ose të shtetasit/es të Bashkimit Evropian konsiderohen :**

**a. bashkëshorti/ja**

b. fëmijët e tij të moshës nën 21 vjeç.

c. **prindërit e bashkëshortit/es** në rast se vërtetohet se bashkëjetojnë me ta.

**5. Të huajt e mësipërm,** kanë mundësi të **përfitojnë leje qëndrimi të pavarur** për një tërësi nga arsyet që parashikohen në L. 2910/01 kur bashkëveprojnë këto predispozita:

a. kur **tejkalojnë nivelin e moshës** në lidhje me rastin **b** të paragrafit të mësipërm.

b. kur **lëshohet vendimi i divorcit.**

c. kur Greku ose shtetasi i Bashkimit Europian, **ushtron dhunë mbi këta persona.**

#### **Lëshimi i lejes së qëndrimit**

Për paisjen me leje qëndrimi të bashkëshortit të qytetarit Grek, ose qytetarit të Bashkimit Europian, duhet që i interesuari i huaj të deponojë **kërkesë në bashki ose në komunën e vendbanimit të tij.**

Kërkesa duhet të shoqërohet nga këto dokumenta:

a. fotokopje **ekzakte e pashaportës** ose e **dokumentit tjetër udhëtues.**

b. **tre fotografi me ngjyra.**

c. **çertifikatë martesë** e legalizuar zyrtarisht.

d. Fotokopje **ekzakte e letërnjoftimit të bashkëshortit/es** kur ai është Grek, ose të lejes së qëndrimit të tij në rastin e qytetarit të Bashkimit Europian.

f. **deklaratë përgjegjësie të L. 1599/1986** e bashkëshortit/es Grek/e ose shtetasit të Bashkimit Europian se: martesa është në fuqi, ose çertifikatë familjare e freskët.

Mbulohen nga leja e prindit por duhet të deponojnë **kërkesë të shoqëruar nga këto dokumenta :**

a. fotokopje **ekzakte e pashaportës,** ose e **dokumentit tjetër udhëtues.**

b. **çertifikatë familjare** nga vendi i nisjes e legalizuar dhe e përkthyer zyrtarisht.

c. **dokument zyrtar nga organi i huaj,** (p.sh. vendim të gjyqit të huaj, marrëveshje e prindërve për kujdesin e ligjshëm të fëmijëve etj.), të legalizuar dhe të përkthyer zyrtarisht.

#### **Fëmijët nën moshën**

**14 vjeç**

**të bashkëshortit/es**

**Grek/e ose të shtetasit të Bashkimit Europian**

**Kërkesa bëhet nga personi që ushtron përkujdesin prindëror** dhe shoqërohet nga këto dokumenta:

a. fotokopje e **pashaportës** ose e **dokumentit tjetër udhëtues.**

b. **dy fotografi me ngjyra.**

c. **çertifikatë familjare nga organet e huaja** e legalizuar dhe e përkthyer .

d. **dokument zyrtar nga organi i huaj i legalizuar dhe i përkthyer** (p.sh. vendim të gjyqit të huaj, marrëveshje e prindërve për ndarjen e përkujdesit prindëror të fëmijëve në mënyrë ligjore etj.).

**Tek fëmijët adoleshentë që kanë plotësuar vitin e 14-të të moshës së tyre** **lëshohet leje qëndrimi personale, e cila ndjek fatin e asaj të prindit që ushton përgjegjësinë prindërore, deri në momentin e arritjes së moshës.**

## HYRJA DHE QËNDRIMI I TË HUAJVE PËR ARSYE TË TJERA

<p><b>Neni 35 i L.2910/01</b> (Neni 19 par. 7 a, b &amp; c i L. 3013/02</p>	<p>Me këto Nene përcaktohet hyrja dhe qëndrimi i anëtarëve të këshillave drejtuese, administratorëve dhe personelit të ndërmarrjeve të huaja.</p>
<p><b>Neni 36 i L.2910/01</b> (Neni 19 par. 8 i L. 3013/02</p>	<p>Me këto Nene përcaktohet hyrja dhe qëndrimi për krijuesit shpirtërorë të huaj dhe anëtarëve të grupeve kulturore dhe të cirkut.</p>

## RASTE TË TJERA TË LËSHIMIT TË LEJES SË QËNDRIMIT

<p><b>Neni 37 par. 1, 2, 3 i Ligj. 2910/01</b> (Neni 20, par. 1. A, B dhe par. 2 i L. 3013/02 dhe neni 8, par. 1. i L. 3146/03 Lejohet lëshimi i lejes së qëndrimit për një vit për të huajin, që disponon të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të jetesës, e cila mund të përtërihet për kohë të barabartë në qoftë se, është paisur me vizë për këtë qëllim.</p>	<p>Për lëshimin e vizës specifike, duhet të deponojë në Konsullatën Greke të vëndbanimit të tij, dokumentat e mëposhtme:</p> <p><b>A. pashaportë ose dokument udhëtues</b>, që njihet nga institucionet ndërkombëtare.</p> <p><b>B. Fakte që tregojnë se: disponon të ardhura për mbulimin e shpenzimeve të jetesës së tij</b> pa ofruar punë në vartësi ose pa ushtruar aktivitet të pavarur dhe burimi i të ardhurave të tij është i ligjshëm.</p> <p><b>C. Deklaratë nga e cila do të rezultojë sigurimi i strehimit.</b></p> <p><b>D. Çertifikatë shëndeti</b> nga e cila rezulton se nuk vuan nga sëmundje të dëmtimit në masë.</p> <p><b>E. vërtetim sigurimi</b> për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, përkujdesit mjeksor dhe farmaceutik.</p> <p><b>E. çertifikatë të amzës penale të organeve të huaja.</b></p> <p>Pas dhjetë vjetësh qëndrimi total në Greqi dhe nën të njëjtat predispozita, me vendim të Sekretarit të Përgjithshëm të qarkut të afërm, mund të lëshohet leje qëndrimi me afat të papërcaktuar.</p>
---	---

<p><b>Neni 37 i L. 2910/01 (Neni 20, par.4. a, b, c, d L. 3013/02 dhe Neni 8, Par. 2 i L. 3146/03) L. 3202/03 Neni 32, par. 7</b></p>	<p>Me vendim të Ministrisë së Brëndshme, Administrimit Publik dhe Decentralizimit, të Punës dhe Sigurimeve Shoqërore <b>lejohej lëshimi i lejes së qëndrimit një-vjeçare, e cila mund të përtërihet çdo herë për një vit:</b></p> <p>A. Për personat që <b>nuk përmbushin predispozitat e qëndrimit të ligjshëm, kur për arsye kryesisht të natyrës humane, bëhet i pamundur largimi i tyre nga territori grek. Për personat e mësipërm jepet mundësia e studimit të kërkesës relative, kur nuk kanë hyrë si klandestinë ose për turizëm.</b> Lejet e qëndrimit që lëshohen, në përputhje me urrdhëresën e mësipërme, kanë mundësi të përtërihen për njërën nga arsyet e L. 2910/01, në rastin kur arsyet e natyrës humane zhduken ose në rastin kur kjo gjë është përcaktuar me vendimin e lëshimit të lejes. Kërkesa deponohet në Drejtorinë e të Huajve dhe Emigracionit të Ministrisë së Brëndshme, Administrimit Publik dhe Decentralizimit.</p> <p><b>B. Për të huaj të cilët detyrohen për arsye të dhunës të largohen nga vendi i tyre.</b></p> <p><b><u>Leja është e përkohëshme dhe ka afat deri në momentin e arsyeve për të cilat u lëshua.</u></b></p> <p>C. Për të huaj shkencëtarë të cilët janë dalluar për ofertën e tyre në fushën e kërkimeve dhe të shkencës.</p> <p>D. Për të huaj shkencëtarë të teknologjive të reja dhe veçanrisht të informatikës.</p> <p>Lejet e qëndrimit të këtij paragrafi si dhe ato që janë lëshuar në përputhje me Nenin 13 të Ligj. 2713/1999 dhe janë në fuqi, vlejné edhe si leje pune. Veçanrisht për lejet e qëndrimit që lëshohen për arsye humanitare (këtu A, B), nuk kërkohet pagesa e kuotës(paravolos), e nenit 71.</p>
